



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:265105

Datë: 12.10.2020

Numri i dokumentit: 01180183

**P.nr. 1046/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit F K , sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.2523/19 të dt.13.11.2019 për shkak të veprës penale: të kanosjes nga neni 181 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit F K , i dëmtuari D K dhe të prokurorit të shtetit Sadije Muriqi me dt .12.10.2020, ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri F K i lindur me dt.... në Pejë rruga “ ... K” nr.10 a”,ku edhe tani jeton , i njohur me dokument identifikues numër ..., i biri i D dhe nënës N e gjinisë Z ka të kryer fakultetin dhe masterin , me profesion kontabilist, i martuar babai një fëmije , i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Me dt. 23.10.2019 rreth orës 12:30 , në shtëpinë e tij rruga “ ...” nr. 10, i dyshuari i lartcekur , ka kanosur me fjalë tjetrin dehe atë të dëmtuarin – babanë e tij Sinë K , në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin mes vete i ishte drejtuar me fjalët “për 24 orë dua me mi jap 20.000 eki qare pa mi jep ose bahet si në I , nuk dua ndërtim por dua pare me i paguar borxhet që i kam” pastaj i dëmtuari – babai ka iniciuar rastin në polic i ku pasi kishte kuptuar i pandehuri ishte kthyer në shtëpi dhe i ishte drejtuar me fjalët “ose heke deklaratën në polici ose të vras kam me të kall me kerr e me krejt, dhe nëse nuk mi jam për 24 orë 20.000 euro do të qoj në ajër dhe do ta jap plumb”, me çka tek ky i dëmtuari shkakton frikë dhe panik .

-me çka ka kryer vepra penale : të kanosjes nga neni 181 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurës konform nenit 38,39, 81 dhe 82 dhe nenit 181 par 2 të KPRK-së I SHQIPTON

**VËREJTJE GJYQËSORE**

Me të cilën të pandehurit i behët me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbënë vepër penale për të cilën nëse ai sërish e përsëritë gjykata do ti shqiptoi sanksion më të rëndë penal.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 15 euro , kurse ne emër te taksës për mbrojtjen e viktimave të krimit shumën prej 30 euro - të gjitha këto 15 ditë pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.13.11.2019 kundër të pandehurit F K, ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2523/19, për vepër penale: të kanosjes nga neni 181 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të dëmtuarit , i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë renduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë e që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, , e në veçanti të dhënë se i pandehuri është i vetmi mbajtës i familjes 3 anëtarësh por mbi të gjitha fakti se i dëmtuari dhe babai i tij ka deklaruar “se me të Fin kanë raporte të shkëlqyera, se kundër tij nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë për kompensimin e dëmit” dhe kësisoj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 të KPPRK-së.

Vendimi obligimin e të pandehurit për taksat për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë konform Ligjit nr. 05/L-036

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.12.10.2020.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### **KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .